



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-4683/24  
Kaçanik, 29.02.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29 shkurt 2024, në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje 26, mungoj me arsye Edon Baftiu.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Zahir Doda- DA, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Hafize Sallahi-DKRS, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Hidajete Guri, Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e II (dytë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2024, data 29 shkurt, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Vjetor i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;
3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar – Dhjetor 2023;
4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2023/2024 ;
5. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2023;
6. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023;
7. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite;
8. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Për 99 vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
9. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër për 15 vite;
10. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
12. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1940/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli;

13. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1934/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Adnan (Feriz) Vishi;
14. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1938/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Ramiz (Afiz) Shaqiri.
15. Diskutim për Planit Zhvillimor Komunal-PZHK.

Pika 15 ka hyrë në rend pune me propozim e Ardita Rrahmani, e cila në emër të GP të LDK e cila kërkoj të futet në diskutim PZHK, ndërkaq e kishte iniciuar edhe në KPF.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkoj të hynë në rend pune pika e 15, çështje kjo e ngritur edhe në KPF. Drejtori është i njoftuar për me qenë i përgatitur për këtë pikë.

**z. Agim Mani:** Meqë nuk kemi pas koordinim paraprak dhe rendi i punës është shumë i ngjeshur, ne jemi të procedojmë vetëm me pikat sipas ftesës për mbledhje, 1-14. PZHK me debatuar na merr kohë, kjo çështje është e nevojshme të debatohet në një mbledhje vetëm të KK si pikë e vetme.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne kemi qenë pjesëmarrës dhe i kemi kontribuar debatit në KPF. Është e drejtë e secilit a është për apo kundër, ndërkaq pavarësisht sa zgjatë mbledhja, ne jemi këtu për t'i kontribuar debatit. Nëse e shtyjmë këtë pikë për një mbledhje tjetër, arsyet duhet me i thënë këtu me saktë, se për kundër që është shtyrë për 4 vite PZHK, jemi duke e shtyrë edhe për 1 muaj për shkakun e juaj.

**z. Adnan Reka:** Mbi çfarë baze do të diskutojmë PZHK Ardita, kur nuk kemi material. Nëse është dashur me diskutuar për PZHK, paraprakisht është dashur me futur ne rend pune dhe me pasur materialin, pavarësisht çfarë kritikash keni dhe a janë të qëndrueshme ato kritika.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo çështje është iniciuar edhe në KPF, është kërkesë me u futur ne rend pune diskutimi i PZHK, kjo ka me qenë informatë, nuk ka me u votuar dhe nuk besoj se na merr shumë kohë diskutimi i PZHK. Për mua propozimi është i arsyeshëm me u diskutuar, a kalon apo jo është çështje tjetër.

**z. Adnan Reka:** Nëse është ashtu, është dashur të ngritet si pyetje në KK, përgjigjen e jep drejtorja, se ne nuk mundem me diskutuar këtë PZHK pa material.

**z. Rrustem Zenuni:** Kërkesa e ngritur edhe pse është me vonesë, ne PDK mendojmë se është mirë të jetë në rend pune, ndërkaq po të kishte materialin, do të ishte me mirë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Për mungesë të informatës, unë po kërkoj diskutim për çështjen e PZHK. Drejtori përgjegjës na sqaron se ku ka arrit çështja e PZHK?

**z. Agim Çaka:** Propozimi me u futur në rend pune kjo pikë, është brenda rregullores dhe duhet me dal në votim, ndërkaq anëtarët e KK duhet me pasur materialin. Se ku ka ngelë çështja e PZHK, kemi bërë pyetje në vazhdimësi në mbledhje të KK. Propozimi për diskutim të PZHK duhet të shtrohet në votim, nëse kalon, hynë në rend pune.

**z. Naim Beça:** Nëse është kërkesë e opozitës, pse nuk e mbajmë një mbledhje të KK me diskutuar vetëm çështjen e PZHK? Ne si opozitë mund të kërkojmë tani me u shtuar edhe 20 pikë tjera dhe me mbetur gjatë në mbledhje të KK. Ne nuk jemi të papërgatitur për këtë pikë dhe nuk mundem me dhënë kurrfarë kontributi.

**z. Agim Mani:** Ne jemi për miratimin e rendit të ditës me pikat sipas ftesës për mbledhje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për drejtorin është me mirë me u larguar kjo pikë, se përgatitet për ndonjë mbledhje tjetër, por miratimin e kemi marrë në KPF me u diskutuar PZHK. PZHK ka me u miratuar kur të vjen materiali në KK, sot do të diskutohet se ku ka ngelë çështja e tij. Kërkesën e Ardites e shtroj në votim për aprovim. Për votuan shumica. Kundër 8 anëtarë nga

LVV. Abstenim nuk ka. Në saje të rezultatit të votimit, del konstatimi se, Kërkesa për diskutim të PZHK, futet në rendin e punës. Atëherë, Rendin e punës me shtimin e pikës 15 e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

#### **APROVOJ**

#### **Rendin e punës në përbërje prej 15 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

#### **1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;**

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë s'ka. Abstenim nuk ka, ndërkaq 8 anëtarë nga LVV nuk morën pjesë në votim, 7 prej tyre nuk kanë qenë pjesë e mbledhjes se kaluar, për shkak se i kanë bojkotuar punimet e mbledhjes. Në saje të kësaj del konstatimi se KK,

#### **APROVOJ**

#### **Procesverbalin e mbledhjes së I (parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik të datës 31.01.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-2329/24.**

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Kadrije Lika-Troni:** 1. Kërkoj nga DSHMS të merr iniciativë për zgjerimin e kapaciteteve të shërbimeve laboratorike, pasi kanë kaluar ankesa të ndryshme lidhur me organizimin e këtyre shërbimeve. Unë mendoj se duhet të eliminohet mënyra e ofrimit të shërbimeve laboratorike me termin, ku qytetarët detyrohen të vijnë 2 ditë radhazi për shërbime laboratorike, 1 ditë për termin, e ditën tjetër për me kryer analiza. Shëndeti i qytetarëve tonë duhet të jetë çështje primare dhe përgjegjësi e gjithë neve, andaj kërkoj t'i jepni përkrahje kërkesës time.

2. Pyetja 2 është për DUKMM, Në f. Kovaçec, rruga: "Mynir Thaqi" që lidhë rrugë: "Hamzë Jashari" me rrugën e "UÇK-së" e cila kalon mbi urën e lumit Lepenc në Kovaçec, kësaj rruge i mungon ndriçimi publik dhe trotuari. Kjo rrugë është shumë e frekuentuar nga banorët, ka rrezik permanent për këmbësorët. Kërkoj nga drejtoritë përkatëse të marrin veprime të duhura për këtë kërkesë.

**z. Adnan Reka:** Pyetja është për Kryetarin e Komunës: Çfarë keni bërë konkretisht, apo cilët janë hapat ligjor apo administrativ që keni marrë pas konstatimit të komisionit komunal për mbikëqyrje dhe realizim të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, se Mevlud Zharku si palë kontraktuese ka shpërfillur kontratën dhe ligjin në lidhje me pronat shoqërore të komunës në sipërfaqe me tepër se 2.5 hektarë ? I rikujtojmë disa nga shkeljet ligjore që janë konstatuar: Ka bërë ndryshimin e pronarit, nuk ka respektuar planin dinamik, nuk ka respektuar planin e biznesit, ka ndërtuar objekte pa leje dhe shumë shkelje tjera.

**z. Naim Beça:** Kam 2 kërkesa dhe 1 pyetje: 1. Është hera e 5-6 që kam ngritur çështjen për ndriçimin e rrugës "Sali Bajra". Pse nuk bëhet ndriçimi publik i kësaj rruge? Njëherë e kam përmendur se është rrezik permanent për fëmijët që vijën nga shkolla, se është rrugë një kahe dhe qentë endacak në qytet janë shtuar shumë, por nuk u rregullua ndriçimi publik në atë rrugë. Pronarët e lokaleve përgjatë asaj rruge janë ankuar për çështjen e rrezikimit të lokaleve të tyre, se janë 10 lokale. Kërkoj të rregullohet ndriçimi në atë rrugë, se rruga është shumë e qarkullueshme, mungesa e ndriçimit publik paraqet rrezik permanent.

2. Çështja e kubzave, u bë një lloj tragjedi- komedie, e keni parë edhe vet se keni kaluar atypari. Duhet me u rregulluar mirë kubzat njëherë e përgjithmonë, e jo çdo muaj me intervenuar.

3. Bllokimi i korzës të Bulevardi: "Ismail Raka", aty ku është ndërtuar ura, u bllokuar me hekura. Duhet me kërkuar nga kompania me liruar rrugën, se nuk është duke punuar aty, se ka pasur raste kur janë lënduar fëmijët duke kaluar atypari.

